



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot.

Lezhë, më ____/____/2022

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data 23/06/2022

Drejtuar: “DRINI A” SH.P.K, me adrese Lagjja “Nen Tereza”, godina ne rrugen nacionale Lezhe-Shkoder km I-re, ne zonen kadastrale 8632, me nr. pasurie 13/55-1, volum 24, faqe 225, Lezhe.

Procedura e prokurimit/lotit: E Hapur e Thjeshtuar/ Mallra

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-31272-05-31-2022

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje materiale per mirembajtjen e sistemit ujites, kullues dhe disiplinimin e ujrave te shiut”.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 Muaj nga data e nenshkrimit te Marreveshjes Kuader.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto ☐

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “DRINI A” SH.P.K, me Nuis J67902505V, me oferte ekonomike 7,832,700 (shtate milion e teteqind e tridhjetë e dy mije e shtateqind) Lek pa TVSH,
2. Operatori Ekonomik “SAM-ARS 2016” SH.P.K, me Nuis L62629204V, me oferte ekonomike 6,885,520 (gjashte milion e teteqind e tetedhjetë e pese mije e peseqind e njezet) Lek pa TVSH,
3. Operatori Ekonomik “STELLA” SH.P.K, me Nuis J87603505T, me oferte ekonomike 6,756,500 (gjashte milion e shateqind e pesedhjetë e gjashte mije e peseqind) Lek pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

I- Operatori Ekonomik “SAM-ARS 2016” SH.P.K, me Nuis L62629204V,

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

Se pari, nuk ploteson piken 1/a, te kriterëve te veçanta te kualifikimit ku parashikohet se “1.Ofertuesi duhet të paraqesë: a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8”,

pasi OE ka paraqitur nje format “Formulari Permbledhes te Vetdeklarimit”, qe nuk eshte miratuar ne DST-ne, e procedures se prokurimit me objekt: “Blerje materiale per mirembajtjen e sistemit ujites, kullues dhe disiplinimin e ujrave te shiut”.

- I. Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE, konstatohet se ky OE ka paraqitur nje Formular Permbledhes te Vetdeklarimit, qe i perket Dokumentave Standarte te Tenderit per proceduren e prokurimit te llojit “Pune” dhe jo “Mallra”.
- II. KVO thekson se procedura e prokurimit me objekt: “Blerje materiale per mirembajtjen e sistemit ujites, kullues dhe disiplinimin e ujrave te shiut”, eshte procedure “E hapur e thjeshtuar/ Mallra”.
- III. Gjithashtu verehet se per kete procedure prokurimi, Njesia e Prokurimit ka perdorur dokumentat standarte te tenderit per llojin e procedures “E hapur e thjeshtuar/ Mallra”.
- IV. KVO mban ne konsiderate se ne nenin 14, te VKM-se Nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” parashikohet se: *“APP-ja harton dhe miraton me vendim formatin e dokumenteve standarde te tenderit qe do te perdoren gjate procedurave te prokurimit, per cdo lloj procedure prokurimi sipas nenit 41, te LPP-së, dhe cdo tip kontrate”*.
- V. Po ashtu KVO mban ne konsiderate se formati i Formularit Përmbledhës te Vetëdeklarimit per procedurat e prokurimit “E hapur e thjeshtuar/ Mallra” eshte miratuar me vendimin nr. 03, date 09.06.2021 *“Per miratimin e dokumentave standarte te tenderit per mallra, pune , sherbime per proceduren e prokurimit “Procedure e Hapur e thjeshtuar”, e korrigjuar me ane shkreses Nr. 2416/6, date 14.06.2021 dhe asnje autoritet kontraktor apo operator ekonomik nuk mund te modifikojë apo te ndryshojë formularet e miratuar ne DST.*
- VI. Gjithashtu ne dokumentat standarte te tenderit te procedures se prokurimit me objekt “Blerje materiale per mirembajtjen e sistemit ujites, kullues dhe disiplinimin e ujrave te shiut”, ne seksionin I, udhezime per Operatoret Ekonomike, ne piken B/4, percaktohet se: *“Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: **Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim**; nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar”*.
- VII. KVO argumenton se edhe permbajtja e deklaratave ne “Formularin Përmbledhës te Vetëdeklarimit”, per procedurat e prokurimit “Pune”, eshte e ndryeshme nga **permbajtja e deklaratave** ne “Formularin Përmbledhës te Vetëdeklarimit” per procedurat e prokurimit “Mallra”, ne vecanti *“Pjesa III, Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”* dhe si rrjedhoje nuk permbush qellimet per te cilat eshte kerkuar ky formular ne DST-ne e kesaj procedure prokurimi.

Nisur sa me lart, KVO thekson se ne kete rast jemi përballë mosplotësimit në formën e duhur të një shtojce e cila është pjesë përbërëse e dokumentave të procedurës së prokurimit, e cila eshte e detyrueshme që të plotësohet sipas formatit të miratuar nga organet ligjzbatuese.

Se dyti, nuk ploteson kriterin 2.3.4 të kriterëve të vecanta të kualifikimit ku parashikohet se: *Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/ Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar për mallrat e mëposhtem:*

Nr.	Emertimi
1	Tub HDPE SN8 (I brinjezuar)
2	Çimento

- I. Komisioni i Vleresimit të Ofertave verën se për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për secilin nga mallrat e kerkuar Autorizim/ Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar.

Ne rast paraqitje të Autorizim/ Marrëveshje me distributorin e autorizuar është detyrim i këtij të fundit që të provojë se është distributorin e autorizuar duke paraqitur autorizimin/ marrëveshjen apo cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis distributorit të autorizuar me prodhuesin.

- II. Nga verifikimi në SPE rezulton se për mallin “Çimento”, operatori ekonomik ka paraqitur autorizim nga një operator (furnizues) i cili nuk është prodhues, si dhe nuk provon që është distributor i autorizuar nga prodhuesi, pasi në autorizimin e paraqitur mungojnë të dhëna nëse OE që ka leshuar autorizimin është distributorin e autorizuar.
- III. KVO duke pasur në konsideratë se të gjithë prodhuesit e kanë detyrim ligjor pajisjen me leje mjedisore nga QKL, bëri një kërkim në faqen zyrtare qkb.gov.al, ku rezultoi se subjekti i cili ka leshuar autorizimin për “Çimento”, nuk disponon QKL si prodhues i Çimentos, por disponon license vetëm për “Transport rrugor ndërkombëtar mallrash për të tretë e me qira”, si dhe license për “Transport mbetje jo të rrezikshme”.

Nisur sa më lart duke qenë se subjekti i cili ka leshuar autorizimin për “Çimento”, nuk disponon QKL si prodhues i Çimentos, si dhe nuk provon që është distributor i autorizuar nga prodhuesi, ky kriter konsiderohet i përmbushur.

Sa më sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur nënën 76, pika 3/a dhe nënën 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e

operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në bazuar në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e Operatorit Ekonomik “SAM-ARS 2016” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Operatori Ekonomik “SAM-ARS 2016” SH.P.K me Nuis L62629204V, skualifikohet.

II-Operatori Ekonomik “STELLA” SH.P.K me Nuis J87603505T,

Nga vleresimi i dokumentacionit të Operatorit Ekonomik “STELLA” SH.P.K, me Nuis J87603505T, klasifikuar i pari në procedurën e prokurimit me Numer REF-31272-05-31-2022 dhe me objekt: “Blerje materiale për mirëmbajtjen e sistemit ujëtes, kullues dhe disiplinimin e ujërave të shiut”, rezulton si më poshtë vijon:

KVO, bazuar në pikën 1 dhe 5, të nenit 82, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

- a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;
- b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Dhe

bazuar piken 1, 6 dhe 7 te nenit 26, te VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

si dhe pas njoftimit nga ana e AK-se për dorëzimin e dokumentacionit të ofertës, Operatori Ekonomik “STELLA” SH.P.K, përfaqësuar nga administratori Z. Lirim Torba, është paraqitur me datë 20.06.2022 për dorëzimin e dokumentacionit sipas ofertës së datës 13.06.2022.

Sa më sipër Komisioni i vlerësimit të ofertave pas marrjes në dorëzim të dokumentacionit të dorëzuar nga OE “STELLA” SH.P.K, mori në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar dhe konstatoi se:

Se pari, nuk ka paraqitur dokumentacionin për të provuar plotësimin e pikës (b) të nenit 26/6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit, nuk rezultoi që OE të ketë paraqitur vërtetim që operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së.

KVO thekson se ky kriter është vendosur nga ligjvëniesi me anë të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe është i detyrueshem për tu zbatuar nga çdo autoritet kontraktor dhe operator ekonomik.

Se dyti, nuk plotëson pikën (e) të nenit 26/6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjen “e”, të pikës 2 të këtij neni ku kërkohej se *“Operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohej për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë”*, pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit, vërehte se OE ka paraqitur vërtetimin me nr. OSHEE-2022-4959085-XZ, datë 30/03/2022, në të cilin rezultoi se OE “STELLA” SH.P.K., të ketë 0 leke detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri me datën 30.03.2022, përfshirë faturën koherente të muajit shkurt 2022.

KVO vëren se, për përmbushjen e këtij kriteri Operatorët Ekonomik duhet të paraqesin Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike përfshirë ku në rastin konkret përfshihet edhe muaji Prill 2022.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE, rezultoi se ka dorëzuar vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike pa përfshirë detyrimet e maturuara të muajit Prill 2022.

Referuar afatit të zhvillimit të procedurës së prokurimit, rezultoi se kjo procedure është zhvilluar më datë 13.06.2022 dhe si rrjedhojë, KVO thekson se detyrimet e energjisë elektrike për muajin Prill 2022, janë tashmë të maturuara dhe afati i fundit për shlyerjen e tyre ka qenë data 31.05.2022. Në këtë kuptim referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit (13.06.2022), KVO vlerëson se, OE “STELLA” SH.P.K., nuk ka përmbushur pikën (e) të nenit 26/6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, lidhur me shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, në përputhje me përcaktimet në dispozitat ligjore/nënligjore në fuqi.

KVO thekson se të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe KPP me vendimin nr. 949/2021 lidhur me detyrimet e maturuara të energjisë elektrike.

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetur në nenin 76, pikë 3/a dhe në nenin 77, pikë 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale,

autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në bazuar në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e Operatorit Ekonomik “STELLA” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Operatori Ekonomik “STELLA” SH.P.K me Nuis J87603505T, skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “DRINI A” SH.P.K, me adresë Lagjja “Nen Tereza”, godina në rrugën nacionale Lezhe-Shkoder km I-re, në zonën kadastrale 8632, me nr. pasurie 13/55-1, volum 24, faqe 225, Lezhe, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 7,832,700 (shtatë milion e teteqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëqind) Lek pa TVSH është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109, të Ligjit Nr. 162/ 2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

KRYETARI

Pjerin NDREU
